



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1 pika b nga Ligji për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihmë në sektorin e politikës për "Bujqësi dhe zhvillim rural" (IPARD) (Gazetar zyrtare e RM nr. 38/2016), në bazë të Pjesës II masë Investimet në mjetet materiale të ekonomive bujqësore pika 11 nga Programi për përdorimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë për zhvillim rural në Unionin Evropian (IPARD) për periudhën 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 177/2016), dhe në bazë të nenit 6 nga dekreti për mënyrën dhe procedurën e shfrytëzimit të mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga IPARD 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 64/2016) dhe nenit 4 të Dekretit për ndryshim dhe plotësim të mënyrës dhe procedurës për shfrytëzim të mbështetjes financiare për masat për zhvillimin rural të financuar nga programi IPARD 2014-2020 ("Gz.zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.58/2019).

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural
më 29 shkurt 2020 publikon

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2020

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve në lidhje me masën 1 Investime në mjetet materiale të ekonomive bujqësore nga IPARD Programi 2014-2020

PJESA I

1. Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) si institucion përgjegjës dhe organ kontraktues për zbatimin e Instrumentit për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural të BE (IPARD) ju bën thirrje të gjithë personave fizik dhe juridik të Republikës së Maqedonisë të dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi 2014-2020 për masat në vijim:

Masa 1 - Investime në mjetet materiale të ekonomive bujqësore

2. Mbështetja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë nga 75% mjete të siguruar nga Instrumenti për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) në përputhje me Marrëveshjen Financiare 2014-2020 dhe 25% mjete të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

3. **Mjete financiare sipas kërkesës individuale** shpërndahen si mbështetje financiare e pakthyeshme (grant) në shumë prej:

3.1.60% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimeve për masën Investime në mjetet materiale të ekonomive bujqësore. Përqindja rritet deri 65% për investime në ekonomitë bujqësore të propozuara nga ana e bujqve të ri (subjekte fizike në moshë prej 18 deri 40 vjet në ditën e parashtrimit të kërkesës për mbështetje financiare) dhe 70% për investime në ekonomi bujqësore në fushat malore.

4. **Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është më 14 prill 2020**

5. **Mbështetja e përgjithshme financiare në kuadër të kësaj thirrje publike është 9.216.693 euro ose 568.147.394 denarë.**

6. **Tërheqje të formularëve dhe udhëzime:**

Formularët e nevojshëm për "Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020" si dhe "Udhëzimi për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020" në të cilët janë të përmbajtur të gjitha informatat për kriteret, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushtet për financim dhe informatat tjera të cilët janë të nevojshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020, Udhëzues për përgatitjen e Planit Afarist/Propozim Projektit Teknik, Udhëzime për dhënie të dokumentacionit të duhur nga institucionet kompetente dhe informacione të tjera të dobishme në versionin elektronik mund të merren nga ueb-adresa e Agjencisë: www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e shtypura sipas kërkesës për shfrytëzim të mjeteve në lidhje me masën 1 nga IPARD Programi 2014-2020 dhe Udhëzimi për shfrytëzuesit e mjeteve në lidhje me masën 1 nga IPARD Programi 2014-2020 mund të merren drejtpërdrejtë në Agjenci në adresë: **Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, bul. 3-ta Makedonska Brigada nr. 20, (ndërtesa Makedonija Tabak bllok C), 1000 Shkup** dhe në qendrat më të përafërta rajonale ose njësitë e punës në **Agjencinë për nxitje të zhvillimit në bujqësi** çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30. (Lista e qendrave rajonale ose njësiteve rajonale të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi me të dhënat për kontakt është publikuar në ueb adresën www.ipardpa.gov.mk).

7. **Mënyra e dorëzimit të kërkesës:**

Kërkuesi duhet të plotëson dhe të dorëzon Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 për masën individuale 1 - Investime në mjetet materiale të ekonomive bujqësore dhe dokumentacioni shoqëruar siç është theksuar në këtë Thirrje publike.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve në lidhje me masën 1 nga IPARD Programi 2014-2020 dhe dokumentacioni i përgjithshëm i nevojshëm dorëzohet në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të epërm "MOS E HAP" për Thirrjen Publike IPARD numër 01/2020 dhe shënimin e masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesa mund të dërgohet me postë si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në sportelin e Agjencisë.

Vërejtje: Për shkak kryerjes së kontrollit në teren nga ana e Agjencisë duhet që kërkuesi të ketë në vetvete kopje nga dokumentacioni i përgjithshëm i dorëzuar deri te Agjencia.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk ose në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.